



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
INSTITUTI I SHËNDETIT PUBLIK

BULETINI JAVOR I SËMUNDSHMËRISË INFEKTIVE - ALERT

JAVA 31 28 Korrik – 4 Gusht 2024

Për këtë periudhë, kanë raportuar 34 NJVKSH ose 94.4% (=34/36) e tyre

BERAT, BULQIZË, DELVINË, DEVOLL, DIBËR, DURRËS, ELBASAN, FIER, GJIROKASTËR, HAS GRAMSH, KAVAJË, KOLONJË, KORÇË, KRUIJË, KUÇOVË, KUKËS, KURBIN, LEZHË, LIBRAZHD, LUSHNJE, M. MADHE, MAT, MIRDITË, PËRMET, POGRADEC, PUKË, SARANDË, SHKODËR, SKRAPAR, TEPELENË, TIRANË, TROPOJË.VLORË.

Pa raportim brenda afatit, 2 NJVKSH ose 3% (=1/36) e tyre: MALLAKASTËR, PEQIN

NUMRI TOTAL I RASTEVE TË SINDROMAVE TË SURVEJANCËS “ALERT” NË JAVËN 31

	JAVA 31
DIARRE PA GJAK	3454
DIARRE ME GJAK	0
INF. RESP. TE SIPËRME	6150
INF. RESP. TE POSHTËME	2178
RASH ME TEMPERATURË	3
VERDHEZA	0
ETHE E ZGJATUR E PASHPJEGUAR (> 3 JAVE)	0
ANOMALI KONGENITALE	0
KONJUKTIVIT AKUT TEK NEONATËT	0
Numri i Njësive Raportuese	413
% e Njësive Raportuese	93.6% (413/441)

Rash me temperaturë


Nga hetimi epidemiologjik dhe konsultat me mjekët e familjes, mjekun infeksionist dhe atë epidemiolog rastet e mëposhtëme nuk janë të dyshuar për fruth, rubeolë apo linë e majmunit, por për varicelë dhe dorë-këmbë-gojë:

Tiranë – 2 raste


Kavajë – 1 rast

Infeksione respiratore

Trendi në kohë i Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme sipas javëve




Shpërndarja e Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme sipas Grup-moshave




Prirja në kohë e Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme paraqet ulje në javën 31 krahasuar me javën paraardhëse, java 30.

Diarre pa gjak

Trendi në kohë i Diarreve pa Gjak sipas javëve




Shpërndarja e Diarreve pa Gjak sipas Grup-moshave




Prirja në kohë e “Diarreve pa gjak” paraqet rritje në javën 31 krahasuar me javën paraardhëse, java 30.

Prirja e “Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme” në javët 20 – 31 të viteve 2023 dhe 2024. Numri i rasteve.




Në javën 31 të vitit 2024 vërehet prirje në rritje e numrit të infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme.


Frekuenca e “Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme” sipas grupmoshës. Incidenca (raste/10.000)



Frekuenca e hasjes së “Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme” sipas NJVKSH në javën 30 dhe 31 / 2024. Incidenca (raste/10.000)




Prirja e “Diarreve pa Gjak” në javët në javët 20 - 31 të viteve 2023 dhe 2024. Numri i rasteve



Në javën 31 të vitit 2024 vërehet prirje në rritje e numrit të rasteve “Diarre pa gjak”.

Frekuenca e hasjes së “Diarreve pa gjak” sipas NJVKSH në javën 30 dhe 31 / 2024. Incidenca (raste/10.000)



*Vërehet një rritje e incidencës së diarreve në Gjirokastrër krahasuar me javën 30. Numri i diarreve në Gjirokastrër po verifikohen në terren.

Informacion ne lidhje me infeksionin nga virusit i Nilit Prendimor ne Shqiperi 5 Gusht 2024


Që nga fillimi i vitit 2024 dhe deri më 31 Korrik 2024, 8 vende në Europë kane raportuan raste të infeksionit me virusin e Nilit Perëndimor (WNV) tek njerëzit: Austria, Franca, Greqia, Hungaria, Italia, Rumania, Serbia dhe Spanja.

Austria, Hungaria dhe Rumania kane raportuar kohet e fundit raste te Etheve te Nilit Perendimor përveç Francës, Italisë, Greqisë dhe Spanjës që kane raportuar tashmë raste edhe me pare. Serbia ka raportuar gjithashtu kete semundje tek njerëzit.

Rasti i parë ne Europe për 2024 u raportua në Prill 2024 në Sevilje, Spanjë per nje pacient i cili kishte paraqitur shenja te semundjes në Mars 2024. Janë raportuar raste të tjera me fillimin e shenjave klinike në Qershor dhe Korrik 2024. Në Itali, rasti i parë u raportua në Qershor 2024 në Modena, Itali. Ndersa Greqia raportoi për herë të pare kete vit raste me WNV me 5 Korrik 2024.

Perseri ne Korrik 2024 raste u raportuan edhe në Austri, Francë, Hungari dhe Rumani dhe nderkohe kane vazhduar te raportohen raste ne Serbi.

Gjate muajit Korrik 2024 verehen raste te reja perseri ne Itali, Greqi dhe Serbi.



Harta 1. Shperndarja e rasteve ne rajonin Europian

Gjate vitit 2024 ne Shqiperi jane testuar 90 persona per WNV ku vetem gjate muajit Korrik 2024 jane testuar 78 raste (87%) per WNV. **Nga keto jane dyshuar per muajin Korrik – Gusht 2024 74 raste te infektuar me WNV prej te cileve 23 raste jane konfirmuar nepermjet serologjise dhe diagnozes molekulare ndersa 17 raste jane te mundshme duke paraqitur vetem nje rezultat pozitiv serologjik dhe lidhje epidemiologjike ndersa 34 raste mbeten raste te dyshuara per shkak te shenjave klinike. Rasti i pare eshte konfirmuar ne Institutin Pasteur Helenik, pasi jeton ne Greqi por eshte infektuar gjate qendrimit te tij ne Saver te Lushnjes ne muajin korrik 2024.**

Pacientet jane kryesisht persona te moshes mbi 60 vjec dhe kryesisht meshkuj.

Rastet jane kryesisht te shtruar ne sherbimin e semundjeve infektive ne QSUT dhe kane paraqitur shenja klinike si:temperature, ethe, dhimbje koke, peshtjellime, fotofobi, konvulsione, pagjumesi, ngrirje te muskujve te qafes, ndryshime frymemarrje, incontinence urinare etj.

Rastet e konfirmuara dhe te mundshme kane paraqitur kryesisht encefalit ose meningit aseptik.

Deri me tani jane konfirmuar 3 vdekje si pasoje e infektimit me WNV

Rastet jane te shperndara ne disa bashki ku mbizoterojne kryesht bashkite e Lushnjes, Fierit, dhe Kurbin.

Tabela 1. Klasifikimi i rasteve

Raste te dyshuar	Raste te mundshme	Raste te konfirmuara
34	17	23

Tabela 2. Shperndarja e rasteve sipas bashkive

Bashkia	Raste te mundshme	Raste te konfirmuara
Fier	1	6
Lushnje	3	6
Divjake	0	1
Berat	1	4
Kurbin	6	2
Lezhe	1	1
Shkoder	2	1
Kavaje	1	1
Elbasan	2	

Tirane	0	1
Shuma	17	23

Tabela 3. Shperndarja e rasteve sipas gjinise

Gjinia	Raste te mundshme	Raste te konfirmuara
Femer	6	7
Mashkull	11	16

Persa i perket prekjës ne kafshe si zogj dhe kuaj nuk ka te dhena te monitorimit te tyre nga strukturat veterinare dhe mjedisore. Disa te dhena jo te konfirmuara raportojne se gjate nje studimi prane Fakultetit te veterinarisë kane evidentuar pranine e ketij infeksioni tek kuajt.

Gjate kesaj kohe jane kryer hetimet entomologjike ku jane gjetur ne keto zona vektoret perkates te mushkonjave Culex ne format adulte dhe jane marre disa masa ne lidhje me dezinfektimin me adulticid te vektoreve nga bashkite perkatese sipas udhezimeve te ISHP duke zbatuar rregullat e caktuara per te menjanuar demtimin e popullates dhe qenieve te gjalla e mjedisit.